

PLATFORMA

KANDIDATE

FATJONA MEMÇAJ



PRILL 2019

1. Vizioni, Politika dhe Strategjitë në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë Mandatit

1. Vizioni

Prokurorët janë një ndër aktorët kryesorë të sistemit të drejtësisë penale, dhe si të tillë duhet të respektojnë dhe të mbrojnë dinjitetin njerëzor, të drejtat e njeriut, duke kontribuar maksimalisht në sigurimin e procesit të rregullt ligjor dhe funksionimin normal të sistemit të drejtësisë. Ata luajnë një rol kyç në mbrojtjen e shoqërisë nga kultura e mosndëshkimit. Në këtë këndvështrim, roli që i është ngarkuar Prokurorit të Përgjithshëm, si drejtues i Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurori më i lartë në detyrë, nga Kushtetuta dhe ligji, është i një rëndësie dhe përgjegjësie të madhe.

Vizioni im mbi rolin e Prokurorisë së Përgjithshme pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore të vitit 2016, e parasheh atë jo vetëm si një institucion që shkund mykun tradicional dhe e vendos veten, ashtu siç ka qëllim Reforma në Drejtësi, si një ndër aktorët kryesorë të angazhuar për krijimin e një sistemi drejtësie të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit, të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient në goditjen e kriminalitetit, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane,¹ por edhe si një aktor strategjik në uljen e kriminalitetit, përmirësimin e ligjshmërisë së sistemit të drejtësisë penale, forcimit të kapaciteteve të parandalimit të kriminalitetit, reduktimit të pasojave të padëshiruara që vijnë nga ekzistenca e praktikave të gabuara të drejtësisë penale, dhe veçanërisht kultura e pandërshkueshmërisë.

2. Politikat e institucionit.

Institucioni i Prokurorisë në përmbushjen e rolit të tij si ushtrues i ndjekjes penale dhe i përfaqësimit të akuzës në gjyq në emër të shtetit duhet të synojë kundrejt;

- Arritjes së performancës më të lartë në përmbushjen e funksioneve kushtetuese të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar me ligj nga të gjitha nivelet e Prokurorisë.
- Ushtrimit të këtyre funksioneve drejtuar nga parimet e respektimit të procesit të rregullt ligjor, respektimit të të drejtave dhe lirive të individit, përfaqësimit të shtetit në procesin penal, me profesionalizëm, me dinjitet, dhe pa ndikime nga brenda dhe jashtë institucionit, udhëhequr nga sjellja në detyrë dhe jashtë saj në respekt të normave të etikës sociale dhe profesionale.
- Forcimit të bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën e përbashkët kundër kriminalitetit dhe dhënien e kontributit konkret në forcimin ndërkombëtarisht të shtetit ligjor si baza e një shteti demokratik, që ka për qëllim mbrojtjen shoqërore nga krimi.
- Zhvillimit dhe përmirësimit të bashkëpunimit në dimensionin e brendshëm dhe të jashtëm të sistemit të Prokurorisë me qëllim reduktimin e kriminalitetit, përmirësimin e ligjshmërisë së sistemit të drejtësisë penale, forcimin e kapaciteteve të parandalimit të kriminalitetit, dhe reduktimin e pasojave të padëshiruara që vijnë nga ekzistenca e praktikave të gabuara të drejtësisë penale dhe pandërshkueshmëria.

¹ Strategjia e Reformës në Drejtësi, fq.2.



- Rritjes së besimit të publikut tek Prokuroria nëpërmjet përmirësimit të qasjes në drejtësi të publikut.
- Ndjekjes së një strategjie të brendshme institucionale që ka për qëllim fuqizimin e strukturës dhe kapaciteteve institucionale të sistemit të Prokurorisë.

3 Strategjitë

Prokuroria shqiptare duhet të zhvillojë disa strategji për periudhën në vijim për të siguruar një performancë të lartë dhe adresimin e politikave të identifikuara, të cilat do ti përmbledhja në disa drejtime;

- **Arritje e performancës më të lartë në përmbushjen e funksioneve kushtetuese të ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar me ligj nga të gjitha nivelet e Prokurorisë.**

Megjithëse roli i Prokurorit të Përgjithshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në çështje konkrete sipas Kushtetutës dhe ligjit është limituar në kuadër të detyrës që përmbush si prokuror pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, roli që ka në nxjerrjen e urdhërave dhe udhëzimeve të karakterit të përgjithshëm i japin atij mundësinë të përcaktojë politikat e përgjithshme të ushtrimit të ndjekjes penale sipas ligjit, në respekt të të drejtave të njeriut dhe ushtrimit të ndjekjes penale me efikasitet.

Referuar analizave të kryera mbi mënyrën e ushtrimit të ndjekjes penale nga prokuroritë e shkallëve të para në vend, raporte këto zyrtare të Prokurorisë² apo studime të organizmave të tjera publike apo private, konstatohet nevoja e veprimit të Prokurorit të Përgjithshëm brenda kompetencave që i njeh ligji, në drejtim të sigurimit të;

1. Angazhimit personal dhe institucional si titullar i Prokurorisë së Përgjithshme për të siguruar pavarësinë e jashtme dhe të brendshme institucionale, paralelisht me ruajtjen e qëndrueshmërisë së funksioneve kushtetuese të institucionit, përmes nxjerrjes së udhëzimeve të karakterit të përgjithshëm dhe orientimeve për çështje konkrete, brenda kompetencave të njohura nga ligji. Pavarësia e parë si përgjegjësi dhe jo si privilegj.
2. Përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të përfaqësimit të Prokurorisë së Përgjithshme në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese duke dhënë kontributin maksimal në njësimin, zhvillimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë, dhe në demonstrimin e një kujdesi të veçantë në respektimin e standarteve të një procesi të rregullt në raport me përfaqësimin para Gjykatës Kushtetuese.
3. Mbështetjes institucionale dhe personale me qëllim që prokurorët e të gjitha niveleve të kryejnë funksionet e tyre të pashqetësuar nga ndërhyrjet, cënimet apo influencat e paligjshme, në respekt të ligjit dhe në mbrojtje të interesit publik. Duke marrë përsipër të gjitha mundësitë e krijuara nga ligji për të kontrolluar

² Raporte Vjetore të Prokurorisë të Rrethëve Gjyqësore

<http://www.pp.gov.al/web/Raporte_te_Prokurorisë_te_Rrethëve_Gjyqësore_1059_1.php#XMIAqOezZn> aksesuar 25 Prill 2019. Raportime mbi gjendjen e kriminalitetit dhe Raporte Vjetore të Prokurorisë të Përgjithshme nga viti 2010–2017

<http://www.pp.gov.al/web/Raporte_te_Prokurorisë_të_Përgjithshëm_353_1.php#XMIBMegezZn> aksesuar 25 Prill 2019.



drejtësinë dhe konsistencën e qasjes në marrjen e vendimeve nga ana e prokurorëve të të gjitha niveleve. Asnjë prokuror nuk duhet të ndjehet vetëm në kryerjen e detyrës sipas ligjit.

4. Kryerjes nga prokurorët të hetimeve të pavarura, të panshme, dhe të një cilësie të lartë, duke ruajtur fokusin. Kjo konsiston në;

Udhëzimin e prokurorëve për të përdorur gjerësisht dhe mundësisht të gjitha mjetet e kërkimit të provës, të parashikuara nga ligji procedural, që sigurojnë prova të ligjshme, të përdorshme dhe të pakontestueshme para gjykatës. Përdorimin si mjete të fundit, pa të cilat do të ishte e pamundur të provuarit e fajësisë së autorit/ve, të atyre mjeteve të kërkimit të provës, parashikuar nga ligji procedural, që çënojnë në mënyrë të drejtpërdrejt dhe thellësisht të drejtat e individit, të mbrojtura nga Kushtetuta dhe ligji.

Ruajtja e fokusit do të thotë që prokuroritë fillimisht të identifikojnë dhe verifikojnë, nëpërmjet një procesi të përpiktë, të gjitha pretendimet e ngritura nga subjektet që ushtrojnë kallëzime penale. Të identifikojnë ekzistencën e veprave penale, dhe më pas të identifikojnë kundrejt provave të mbledhura në procesin e parë, autorët e këtyre veprave penale. Ky proces do të çonte në regjistrimin e procedimeve penale për hetimin e veprave penale të identifikuara, në kushtet kur nuk ekzistojnë shkaqe të padënueshmerisë, shuarjes së vepres penale apo dënimit penal. Një proces i tillë i mirëvlerësuar do të çonte në eliminimin e kryerjes së hetimeve pa rezultate dhe shpërdorimin e panevojshëm të burimeve njerëzore dhe materiale që i janë vënë në dispozicion Prokurorisë, pa përmendur këtu cënimin e të drejtave të individëve ndaj të cilëve fillon një proces, i cili edhe pse mund të shkojë në pushimin apo deklarimin e pafajësisë së tyre, do të ndikojë thellësisht në të drejtat e tyre civile. Ky vlerësim i kujdesshëm do të bëjë të mundur fokusimin e burimeve njerëzore dhe materiale drejt pasjes së rezultateve më të mira në luftën kundër kriminalitetit me rrezikshmëri të lartë shoqërore; krimin të organizuar, korrupsionit dhe shpërdorimit të fondeve publike, si dhe krimeve të tjera të kryera nga jakat e bardha, krimeve kundër jetës, dhe çdo lloj kriminaliteti tjetër, sidomos ai që për nga magnituda dhe kompleksiteti është bërë problem kombëtar dhe ndërkombëtar.

5. Mirëfunksionimit të mardhënies mes Prokurorisë dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, për hetime sa më të shpejta, për ushtrim të kontrollit dhe drejtimit të hetimeve në mënyrë sa më eficient nga ana e prokurorit me qëllim mbledhje të provave të vlefshme dhe të përdorshme në proces, në shërbim të mbrojtjes së akuzës.
6. Sigurimit të bashkëpunimit mes prokurorive të juridiksionit të zakonshëm, dhe veçanërisht mes këtyre prokurorive dhe Prokurorisë së Posaçme, me qëllim të kryerjes sa më të shpejtë dhe me cilësi të hetimeve paraprake.
7. Vlerësimit të kujdesshëm të kushteve dhe kriterëve të parashikuara në ligj në kërkimet që i paraqiten gjykatës për caktimin e masave të sigurimit personale apo pasurore, dhe në ngritjen e akuzës. Në këto momente procedurale Prokuroria duhet të synojë të ketë në dorë një numër të tillë provash që do të çonin drejt kërkimit të mëpasshëm për dërgimin për gjykim të këtyre individëve.
8. Fokusimit të punës së prokurorëve dhe policisë gjyqësore edhe në adresimin e pritshmërive të viktimave nga veprat penale, duke respektuar të gjitha të drejtat e njohura atyre nga ligji, duke punuar në mënyrë aktive në mbrojtje të mirëqënies së tyre gjatë dhe pas procesit penal.



9. Kritjen e fokusit në hetimin e kujdesshëm të veprave penale ku janë përfshirë grupet vulnerabel, të miturit, të moshuarit, personat me aftësi ndryshe etj, duke kërkuar specializim të mëtejshëm të grupeve hetimore që merren me kryerjen e hetimeve ku këto kategori kanë qënë viktimë, dëshmitarë, por edhe autor i mundshëm i një veprave penale.
10. Përkrah rritjes së cilësisë së hetimeve të veprave penale, kërkohet rritje e cilësisë së procedimeve pasurore të ndërmarra në kuadër të zbatimit të ligjit nr.10192/2009(i ndryshuar). Gjithashtu një vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet sekuestrimit, administrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprës penale gjatë procesit penal.
11. Respektimit të afateve procedurale në lidhje me njoftimin e Avokaturës së Shtetit nga ana e drejtuesve të prokurorive të rretheve gjyqësore, në rastet ku ka dyshime se janë cënuar interesat pasurore të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë publikë, në mbështetje të ligjit 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.
12. Vijimit dhe forcimit të bashkëpunimit shumëplanesh me institucionet e tjera ligjzbatuese.
13. Bashkëpunimit dhe ndihmesës reciproke në ushtrimin e detyrave të ngarkuara nga Kushtetuta dhe ligji me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Përgjithshëm, dhe Ministrinë e Drejtësisë.
14. Vëmendje më e madhe mbi ushtrimin e ndjekjes penale të formave të reja të kriminalitetit si krimi kibernetik, krimet e lidhura me identitetin, krimi mjedisor, por edhe krimeve të "vjetra" për Shqipërinë si trafikimi i organeve, i objekteve të trashëgimisë kulturore etj.
15. Përdorimit të teknologjive të reja dhe risive të shkencës në hetimin e veprave penale, duke ecur hetimi dhe rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe policisë gjyqësore në raport me këto zhvillime dhe përdorimin e tyre nga krimi.
16. Rregullimit të veprimtarisë së policisë gjyqësore, sipas përcaktimeve të nenit 38, pika 1, germa "dh", "g" dhe "gj", të ligjit nr.97/2016.

- **Ushtrimi i pavarur i funksioneve nga ana e prokurorëve dhe policisë gjyqësore duhet të drejtohet nga parimet e respektimit të procesit të rregullit ligjor, respektimit të të drejtave dhe lirive të individit, përfaqësimit të shtetit në procesin penal, me profesionalizëm, me dinjitet, pa ndikime nga brenda dhe jashtë sistemit, udhëhequr nga sjellja në detyrë dhe jashtë saj në respekt të normave të etikës sociale dhe profesionale.**

Rritja e besimit të qytetarit se Prokuroria përmbush detyrimet e saj kushtetuese është rëndësishëm në lulëzimin e shtetit të së drejtës. Në mënyrë të veçantë, institucioni i Prokurorisë duhet të perceptohet si i drejtë, i paanshëm dhe i pavarur në kërkimin e drejtësisë dhe zgjidhjes së çështjeve që i adresohen. Kjo gjë nuk duhet të mbesë në nivele perceptimi por në fakt prokurorët duhet të drejtohen në punën e tyre nga parimet e drejtësisë, paanëshmërisë dhe pavarësisë. Administrimi efektiv i drejtësisë varet nga respekti ndaj institucionit, që krijohet nëpërmjet demonstrimit të dinjitetit, profesionalizmit dhe etikës nga ana prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe stafit mbështetës. Publiku ka të drejtë të përballet me sjellje korrekte, të respektueshme dhe profesionale nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin penal. Prokurorët dhe stafi i prokurorive duhet të jenë të arsimuar dhe trajnuar mirë dhe të marrin mbështetjen e duhur për të arritur performancë të lartë në detyrë dhe për të plotësuar nevojat e publikut.



Për të realizuar këtë është e nevojshme të ndiqen disa strategji, ndër të cilat;

- Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë duhet të mbikqyrë veprimtarinë e prokurorëve të të gjitha niveleve me qëllim që prokurorët në ushtrim të ndjekjes penale të drejtohen nga parimet e respektimit të procesit të drejtë dhe të paanshëm, përfaqësimit me profesionalizëm dhe me dinjitet në akuzës në gjyq, sjelljes në detyrë dhe jashtë saj, në respekt të normave të etikës sociale dhe profesionale. Po kështu edhe policia gjyqësore, në përmbushje të funksioneve të saj duhet të drejtohet nga ligji, respektimi i të drejtave të njeriut, profesionalizmi dhe ndershmëria. Një kombinim i ligjit, trajnimeve të vazhdueshme, dhe respektimit të standarteve do të sigurojnë që prokurorët dhe policia gjyqësore të mbajnë një qëndrim dinjitoz dhe etik gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës.
- Vijimin e bashkëpunimit me institucionet e rivlerësimit për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve.
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit në dimensionin brenda strukturës, por edhe jashtë saj. Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me rrjetet e pavarura të prokurorëve dhe policisë gjyqësore, si dhe me partnerët ndërkombëtarë, që operojnë në Shqipëri në ndihmë të përmirësimit të cilësisë së punës së Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore, por edhe jashtë saj, në rritje të nivelit etiko-profesional dhe shkëmbimit të eksperiencave me kolegë të huaj.
- Bashkëpunim i mëtejshëm me Shkollën e Magjistraturës, Departamentin e Administratës Publike, si dhe partnerët ndërkombëtar për të siguruar trajnimin e prokurorëve, kancelarëve, dhe nëpunësve civil të Prokurorisë.
- Mbikqyrje periodike e ekzekutimit të vendimeve penale, që u takojnë masave të sigurimit dhe gjykimeve të themelit, duke shmangur çdo mundësi për qëndrimin e të pandehurëve apo dënuarve në gjëndje izolimi përtej afateve të parashikuara nga vendimet e gjykatave. Marrja e masave të menjëhershme deri në fillimin e ndjekjes penale ndaj individëve që konstatojnë një gjëndje të tillë dhe nuk marrin masa për ndërprerjen e saj.
- Respektim i kërkesave të ligjit dhe pritshmërisë së publikut mbi zbatimin e ligjit për dekriminalizimin.
- Shqyrtim i kujdesshëm dhe përgjigje në kohë i çdo kërkesë dhe ankese të qytetarëve.

➤ **Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në luftën e përbashkët kundër kriminalitetit, dhe dhënien e kontributit konkret në forcimin ndërkombëtarish të shtetit ligjor si baza e një shteti demokratik, që ka për qëllim mbrojtjen shoqërore nga krimi.**

Kjo gjë mund të realizohet nëpërmjet;

- Vijimit dhe përmirësimit të cilësisë dhe efektivitetit të bashkëpunimit gjyqsor ndërkombëtar nëpërmjet angazhimit të burimeve njerëzore dhe materiale të nevojshme për ekzekutimin sa më të shpejtë dhe me cilësi të kërkesave për ndihmë juridike të ndërsjellë dhe bashkëpunim në fushën penale.
- Zhvillimit të mëtejshëm të bashkëpunimit mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Prokurorisë, si dhe Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë në fushën e marrdhënieve juridiksionale me autoritetet e huaja. Koordinimit më të mirë mes Prokurorisë së



Përgjithshme, drejtorisë përkatëse, dhe prokurorive të rretheve gjyqësore dhe apeleve, si dhe mes vetë këtyre, me qëllim realizimin e procedurave brenda afateve të kërkuara nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe ligji procedural penal.

- Përmirësimit të politikave dhe procedurave që kanë për qëllim krijimin e çdo kanali bashkëpunimi, në respekt të kuadrit rregullator ndërkombëtar, që do të sjellë efikasitet dhe shpejtësi në bashkëpunim, të tillë si bashkëpunimi i drejtpërdrejtë me institucionet analoge. Kjo gjë do të sigurojë konsultime para paraqitjes së kërkesave në drejtim të përmirësimit të cilësisë së kërkesave për asistencë, me qëllim që këto kërkesa të jenë ligjërishit dhe faktikisht sa më konform legjislacionit shqiptar, si dhe konsultime pas paraqitjes së kërkesës në mënyrë që të sqaroheshin pengesa që do të lindnin pas paraqitjes tyre.
 - Vijimit të trajnimeve dhe bashkëpunimit në nivele takimesh formale dhe informale me institucionet dhe agjencitë e huaja ligjzbatuese.
 - Krijimit brenda drejtorisë përkatëse të një sistemi për ndjekjen (tracking) e gjendjes së kërkesës për ndihmë juridike, mbajtjen e statistikave mbi llojet e kërkesave për ndihmë, kohëzgjatjen dhe rezultatet e arritura.
 - Krijimit të skuadrave të përbashkëta hetimore (JIT) si forma eficiente në luftën kundër kriminalitetit të organizuar, terrorizmit, pastrimit të parave.
- **Zhvillim dhe përmirësim i bashkëpunimit në dimensionin e brendshëm dhe të jashtëm të sistemit të Prokurorisë me qëllim reduktimin e kriminalitetit, përmirësimin e ligjshmërisë së sistemit të drejtësisë penale, forcimin e kapaciteteve të parandalimit të kriminalitetit, dhe reduktimin e pasojave të padëshiruara që vijnë nga ekzistenca e praktikave të gabuara të drejtësisë penale, dhe pandërshkueshmëria.**

Kjo gjë mund të realizohet ndërmjet të tjerave edhe nëpërmjet:

- Përgatitjes së statistikave, analizave dhe studimeve nga strukturat përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme mbi format e veçanta të kriminalitetit dhe përgjigjen që ka patur ky lloj kriminaliteti nga ndëshkimi, duke evidentuar efektivitetin e dënimeve të dhëna në raport me parandalimin e këtyre veprave penale. Kjo gjë do të çonte në krijimin e të dhënave të nevojshme mbi bazën e të cilave reflektohet në drejtim të ndryshimeve të nevojshme legjislative, por edhe të qëndrimeve të prokurorëve para gjykatës në raport me llojin e dënimit të kërkuar dhe masat e kërkuara.
- Përgatitja e statistikave, analizave dhe studimeve, në bashkëpunim me Zyrën e UNICEF në Shqipëri apo ente të tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të interesave të të miturve, që kanë për qëllim të vlerësojnë efektivitetin e parashikimeve të reja ligjore në fushën e drejtësisë për të mitur në drejtim të rehabilitimit të të miturve, dhe uljes së numrit të të miturve në konflikt me ligjin.
- Bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe institucionet e tjera për zhvillimin e programeve përkatëse të informimit të të rinjve mbi kriminalitetin dhe luftën kundër tij, programe në të cilat të marrin pjesë aktive edhe prokurorët e të gjitha niveleve, duke ndarë me të rinjtë eksperiencën e tyre mbi dëmin që sjell krimi për shoqërinë dhe individin e përfshirë në të, si dhe rolin e Prokurorisë.
- Përgatitja e statistikave, analizave dhe studimeve, mbi efektivitetin e instituteve të reja procedurale si urdhëri penal dhe marrëveshja, si dhe rolin e tyre të rëndësishëm jo



Handwritten signature

vetëm në drejtim të një procesi sa më të shpejtë por edhe në drejtim të efektit të mundshëm preventiv.

- Rritjes së bashkëpunimit me publikun dhe median për të ndërgjegjësuar publikun mbi rolin e Prokurorisë si organ kushtetues i ushtrimit të ndjekjes penale, por edhe si palë në procesin penal, që ka nevojë për mbështetjen e publikut në përmbushjen e detyrave dhe parandalimin e dëmtimit të shoqërisë nga krimi i çdo lloji në nivelin e rrezikshmërisë. Pra, paraqet rëndësi të madhe ndërgjegjësimi i publikut nëpërmjet bashkëpunimit me median ndaj punës së Prokurorisë, dhe rolit të prokurorit si individ në raport me shoqërinë.
- **Ndjekja e një strategjie të brendshme institucionale që ka për qëllim fuqizimin e strukturës dhe kapaciteteve institucionale të organit të Prokurorisë.**

- Administrimi i institucionit duhet të jetë i drejtë, i saktë, i përshtatshëm dhe efikas. Ky lloj administrimi kërkon planifikim të kujdesshëm, përdorim me efikasitet të burimeve njerëzore dhe materiale, monitorim, vlerësim dhe koordinim ndërmjet secilit komponent të sistemit. Për tu krijuar kushte prokurorëve të përmbushin detyrën duhet që çdo aspekt administrativ i sistemit të funksionojë me kapacitetin më të përshtatshëm të mundshëm. Është e nevojshme që të krijohen struktura të reja dhe të bëhen përmirësimet aty ku është e nevojshme me qëllim për të bërë sistemin eficient.
- Implementimi i parimit të tolerancës zero në raport me korrupsionin dhe keqpërdorimin e fondeve brenda sistemit dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm, duke rritur edhe bashkëpunimin me Kontrollin e Lartë të Shtetit, si institucion i specializuar në auditimin e fondeve publike.
- Rekrutimi dhe ngritja në detyrë në shërbimin e Prokurorisë dhe shërbimin administrativ në respektim rigoroz të rregullave të pranimit në shërbimin civil, të parashikuara në ligjin për nëpunësin civil dhe ligjin nr.97/2016. Rekrutimi duhet të bëhet larg konfliktit të interes, nepotizmit dhe vetëm duke u bazuar në meritat e gjithsecilit. Institucioni do të udhëhiqet nga parimi i respektimit të të drejtave të punonjësve në detyrë, respektimit të barazisë gjinore dhe sigurimit të një ambienti motivues, me qëllim sigurimin e mbarëvajtjes së punës dhe rritjes së efikasitetit dhe respektimit të ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorëve të të gjitha niveleve.
- Rritja e bashkëpunimit me Shkollën e Administratës Publike dhe Shkollën e Magjistraturës, me synim rritjen e aftësive profesionale të nëpunësve civil si dhe të çdo punonjësi të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorëve të të dy niveleve të tjera.

1. **Vlerësimi i situatës në Prokurorinë e Përgjithshme gjatë katërvjeçarit të fundit.**

Prokurorët shqiptarë për një kohë të gjatë kanë ushtruar funksionet e tyre mbi parimin e një centralizimi të fortë, ku urdhërat dhe udhëzimet e prokurorit me të lartë ishin të detyrueshme për prokurorin më të ulët, moszbatimi i të cilave apo shkeljet e ndryshme të ligjit dhe etikës profesionale do të çonin në procese disiplinore të inicjuara, drejtuara dhe përfunduara nga shkalla më e lartë e hirarkisë që ishte Prokurori i Përgjithshëm.

Ndryshimet kushtetuese dhe miratimi i ligjeve të reja në kuadër të Reformës në Drejtësi e sollën rolin e prokurorit në një dimension tjetër, atë të një subjekti me pushtet të gjërë diskrecional, që gëzon pushtet dhe kontroll mbi iniciimin e procesit penal më shumë se



Handwritten signature or initials in the bottom left corner.

çdo subjekt tjetër i drejtësisë penale. Vendimmarrja e prokurorëve mbi fillimin e procedimit penal, kryerjen e veprimeve hetimore, ngritjen e akuzës ndaj një individi të caktuar, përdorimi i marrëveshjes në procesin penal, luan rol thelbësor në përfundimin e procesit dhe ka pasoja të mëdha mbi të pandehurit dhe viktimat e veprave penale, por pse jo edhe mbi mundësinë e shpërdorimit të burimeve njerëzore dhe materiale që i janë vënë në dispozicion.

Natyra e rastësishme dhe arbitrare e vendimmarrjes së prokurorit dhe mungesa e kontrollit të pushtetit prokurorial mund të çojnë në fillime të paligjshme të procedimeve penale, zhvillimin e hetimeve, urdhërimin e sekuestrimeve që do të dëmtonin të drejtat pasurore të personave juridik dhe fizik, por edhe trajtimin e ndryshëm të njerëzve të ndodhur në kushte të ngjashme. Urdhërime të ndryshme, që mund të japë prokurori mbi kryerjen e veprimeve hetimore në kushte flagrante, mund të çojnë në shkelje të rënda të të drejtave të individëve të përfshirë në proces, por edhe të palëve të treta. Pas miratimit të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", në kushtet e mungesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe mosdefinimit të saktë të të drejtave në raport me fillimin e procedimit disiplinor nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, i vetmi organ kontrollues i ushtrimit të ndjekjes penale nga prokurori mbeti gjykata, e cila kontrollon vetëm këtë aspekt të punës së tij. E gjithë kjo çoi deri diku në rritje artificiale të ngarkesës së prokurorëve, ulje të cilësisë së hetimeve, krijimin e praktikave të ndryshme sidomos pas miratimit të ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, cënim të disiplinës dhe përgjegjshmërisë në ushtrimin e detyrës, por edhe mungesë në zbatim të detyrimeve të krijuara nga ligji i ri organik i Prokurorisë për ndryshime në organizimin e punës dhe funksionimin e institucionit.

2. Përparësitë kryesore të Prokurorit të Përgjithshëm dhe arsyet e përzgjedhjes së tyre.

Në mënyrë jo shteruese dhe duke i parë të gjitha parësore për nga rëndësia po listoj disa nga përparësitë kryesore që duhet të udhëheqin përditshmërinë e punës së Prokurorit të Përgjithshëm.

- a) Rritje e nivelit të përfaqësimit në Gjykatën e Lartë dhe Kushtetuese, duke kontribuar në zhvillimin dhe ndryshimin e praktikave gjyqësore, por dhe njësimin e praktikave të ndryshme të krijuara pas ndryshimeve të Kodit të Procedures Penale.
- b) Rritje e performancës në detyrë të prokurorëve të të gjitha niveleve me qëllim arritjen e rezultateve të larta në luftën kundër kriminalitetit të çdo forme.
- c) Bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme për t'i siguruar kësaj të fundit gjithë suportin e nevojshëm për realizimin e funksioneve të saj.
- d) Rritje e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe gjithë stafit të Prokurorisë, duke kontribuar në krijimin dhe vënien në efikasitet të mekanizmave ligjorë për llogaridhënie.
- e) Nxjerrje të udhëzimeve për njehsimin e praktikave të ndryshme, veçanërisht nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, në përmirësim të cilësisë së hetimeve dhe në përgjigje të praktikës së njehsuar gjyqësore.
- f) Nxjerrje dhe përmirësim të akteve normative që kanë për qëllim rregullimin e administrimit të Prokurorisë së Përgjithshme dhe rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm.



- g) Nxjerrje të akteve normative që rregullojnë mardhëniet mes prokurorëve të ndryshme apo mes tyre dhe policisë gjyqësore.
- h) Nxjerrje të akteve përkatëse që kanë për qëllim rregullimin e veprimtarisë së policisë gjyqësore, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me procedimin disiplinor të oficerëve të policisë gjyqësore.
- i) Strukturim të mekanizmave që kanë për qëllim monitorimin e respektimit të këtyre akteve rregullatore nga ana e prokurorëve të të gjitha niveleve.
- j) Krijtje të bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, në drejtim të përmbushjes së më me efektivitet të kompetencave të secilit institucion.
- k) Miratimi të rregullave për emërimin e Zëvendës Prokurorit të Përgjithshëm dhe emërimin e këtij të fundit, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr.97/2016.
- l) Përmirësim dhe monitorim i rregullave për shpërndarjen dhe rishpërndarjen e çështjeve. Realizimi i shortit elektronik në ato prokurori ku nuk kryhet.
- m) Ushtrim i kontrollit të brendshëm mbi menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore dhe fondeve buxhetore të prokurorëve nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Auditim periodik dhe me iniciativë, për çdo veprimtari ekonomike dhe administrative të kryera nga prokuroritë e rretheve dhe të apelit, duke nxjerrë mangësitë dhe orientuar përmirësimin e tyre në të ardhmen.
- n) Inicim pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i inspektimit tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve, si dhe mbi shkelje disiplinore të kryer nga ana e tyre.
- o) Bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar në realizimin e projekteve ku prokuroria është ose do të mund të jetë përfitues.

3. Evidentoni mangësitë e Prokurorit të Përgjithshëm (si institucion kushtetues, nëse ka) dhe adresimin e zgjidhjeve.

Reforma në sistemin e drejtësisë që solli ndryshimet kushtetuese dhe miratimin e ligjeve të reja e pozicionoi kryesisht Prokurorin e Përgjithshëm si prokuror pranë Gjykatës së Lartë dhe Kushtetuese, si rregullator i administrimit dhe mbarëvajtjes së punës në prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm, me qëllim të sigurimit të ushtrimit të funksioneve nga ana e prokurorëve në mënyrë të pavarur dhe sa më me efikasitet, dhe si përfaqësues i Prokurorisë në mardhëniet ndërinstitucionale jashtë dhe brenda vendit. Një pozicionim i tillë ishte qartësisht i lidhur me vizionin e legjislatorit që prokurorët tashmë duhet të ishin autonomë në kryerjen e hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale sipas ligjit dhe përfaqësimin në gjykim. Detyra e Prokurorit të Përgjithshëm duhet të ishte ai i udhëheqësit, respektuesit dhe promovuesit të kësaj autonomie. Ky pozicionim i ri i Prokurorit të Përgjithshëm në sistem u bë pas një analize të kujdesshme, e cila u pasua me ndryshimet përkatëse ligjore në Kushtetutë, ligjin procedural penal dhe miratimin e një ligji të ri mbi Prokurorinë, ndryshime të cilat do të provojë koha se sa të drejta dhe efikase ishin për drejtësinë penale.

4. Sfidat e Prokurorit të Përgjithshëm gjatë mandatit.

II. Aftësia drejtuese dhe lidhësi për të udhëhequr sistemin e Prokurorisë gjatë mandatit

1. Cili është misioni dhe vizioni juaj gjatë mandatit,



a. Misioni

Prokurori i Përgjithshëm duhet ti përkushtohet kryerjes së detyrës me performancën më të lartë duke punuar në drejtim të krijimit në Prokurori të një standarti të tillë pune që i ofron të gjithë qytetarëve shqiptarë procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe mbrojtje të interesit publik, por njëkohësisht të prezantojë një drejtim të ri, më dinjitoz dhe profesional të Prokurorisë.

b. Vizioni

Siç sipërpërshkrova vizioni im mbi Prokurorinë Shqiptare është ai i një organi të pavarur, të paanshem, efikas në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, llogaridhënës, bashkëpunues me gjithë organet e tjera ligjzbatuese, me qëllim uljen e kriminalitetit dhe lehtësimin e pasojave që ai shkakton tek individët dhe shoqëria. Prokuroria shqiptare nuk mund të shihet më vetëm si organ goditës i krimit, por edhe si garantues i barazisë para ligjit, ku asnjë nuk mund të dalë mbi ligjin, parandalues dhe rivendosës në vend i të drejtave të shkelura të personave të afektuar nga krimi ose edhe nga vetë keqadministrimi i drejtësisë penale.

Qëllimi është i një rimodelimi të Prokurorisë duke krijuar një Prokurori që performon në përmbushjen e detyrave të saj me dinjitet, integritet dhe profesionalizëm në përmbushje të standarteve ndërkombetare, e pa influencuar nga interesa individuale apo të grupeve të caktuar, por e udhëhequr nga drejtësia dhe interesi publik.

Rritja dhe organizimi më i sofistikuar i kriminalitetit transnacional duhet ta gjejë të gatshme Prokurorinë shqiptare të radhitet me dinjitet dhe profesionalizëm mes atyre institucioneve homologe që japin një kontribut të qenësishëm në luftën kundër fenomeneve kriminale më të rrezikshme sot në botë, duke përdorur tërë mekanizmat ndërkombëtar të bashkëpunimit gjyqësor në dispozicion.

Parashikimet e reja ligjore që u përfshinë në ligjin e ri për Prokurorinë, ende të paimplementuara, mbi pranimin në shërbimet administrative të Prokurorisë bazuar në rregullat e pranimin në shërbimin civil, krijojnë mundësinë e pranimin në këtë shërbim të individëve më cilësor. Ky pranim dhe llogaridhënia e administratës së Prokurorisë tashmë do të bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit dhe vazhdimësinë e shërbimit civil.

Parashikimi në ligj dhe përfshirja në strukturat e prokurorive e prokurorëve të specializuar dhe koordinatorëve për marrdhëniet me publikun dhe mediat do ta rrisë transparencën dhe bashkëpunimin me median, pa cënuar sekretin hetimor dhe të mediat personale të personave të përfshirë në procese hetimore apo gjyqësore.

2. **Vështirësitë e rolit të Prokurorit të Përgjithshëm, rreziqet dhe masat për kapërcimin e tyre.**

A. **Vështirësitë**



Prokuroria sot përballet me shumë vështirësi të natyrave të ndryshme, të cilat influencojnë në mosarritjen e performancës së duhur në kryerjen e detyrës nga ana e saj, gjë që do të kërkonte nevojën e angazhimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

Ndër më kryesoret mund të përmendim;

Prokuroria e Përgjithshme ka akoma shumë punë për të bërë në drejtim të miratimit të akteve normative që kanë për qëllim mirëfunksionimin e të tërë strukturës, implementimit të ndryshimeve të reja ligjore, krijimit të balancës mes pavarësisë në ushtrimin e detyrës dhe llogaridhënies. Gjithashtu paraqitet e nevojshme marrja e masave konkrete në drejtim të sigurimit të ushtrimit të funksionit nga prokurorët e të gjitha niveleve, duke filluar nga Prokurori i Përgjithshëm, pa asnjë lloj ndikimi të paligjshëm dhe të paarsyeshëm, mundësi kjo e krijuar nga ligji, por e nevojshme për tu përqafuar në përditshmëri nga prokurorët.

Referuar gjëndjes aktuale konstatohen mungesë e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe profesionale, për shkak të largimit të prokurorëve apo numrit të ulët të oficerëve të policisë gjyqësore. Kjo gjë ndikon dukshëm në shpejtësinë dhe efikasitetin e hetimeve paraprake, por edhe në përfaqësimin në gjyq të Prokurorisë, ku aktualisht konstatohet një disproporcion i ndjeshëm mes numrit të gjyqtarëve penalistë dhe prokurorëve, sidomos në prokuroritë e apeleve.

Mosfunksionim i duhur i mekanizmave të përbashkët ndërinstitucional në luftën efektive kundër kriminalitetit, sidomos atij të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit.

Mosfunksionim i mekanizmave të vlerësimit dhe llogaridhënies së prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për shkak të moskrijimit të strukturave të parashikuara nga ndryshimet ligjore, që çoi në faktin se i vetmi kontrollues për momentin i veprimtarisë së prokurorëve do të ishte gjykata dhe deri diku drejtuesi i prokurorisë.

Mungesë përditësimi në informacion në zyrat e prokurorive dhe Prokurorinë të Përgjithshëm mbi numrin dhe llojin e çështjeve të regjistruara, të filluara, të mbyllura deri në dënimet përfundimtare, që do të sigurohej nëse do të ishte funksional sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve, akoma jo funksional.

B. Masat për kapërcimin e tyre.

Ndër masat kryesore që duhet të ndërmerren për kapërcimin e këtyre vështirësive;

Implementimi sa i shpejtë i ndryshimeve ligjore që kanë të bëjnë me statusin, karrierën, vlerësimin etik dhe profesional dhe llogaridhënien e prokurorëve, por edhe me organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë.

Miratimi i akteve normative, që ligji i ka njohur të drejtën për të nxjerrë Prokurori i Përgjithshëm që kanë për qëllim mirëfunksionimin e të tërë strukturës, implementimin e ndryshimeve të reja ligjore, krijimin e balancës mes pavarësisë në ushtrimin e detyrës dhe llogaridhënies.

Të sigurohen kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe materiale për kryerjen e detyrës funksionale. Kjo gjë do të realizohet nëpërmjet bashkëpunimit me Këshillin e Lartë të



Prokurorisë dhe Shkollën e e Magjistraturës mbi rekrutimin e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore.

Përmirësimin e bashkëpunimit me agjencitë e tjera ligjzbatuese në përmirësim të hetimeve, veçanarisht të atyre proaktive.

Bërjen funksional të sistemi elektronik të menaxhimit të çështjeve.

III. Aftësitë menaxheriale gjatë periudhës së mandatit

1. Me qëllim përmbushjen e misionit dhe vizionit në krye të Prokurorisë së Përgjithshme listohen më poshtë pesë prioritetet kryesore dhe arsyet e përzgjedhjes

a. *Qartësimi i strukturës organizative të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të tjera të Juridiksionit të Përgjithshëm, rregullores së Prokurorisë së Përgjithshme dhe rregullores standard të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm.*

b. *Përditësim i procesit buxhetor dhe kontroll efikas i përdorimit të buxhetit*

Neni 38 i Ligjit nr.97/2016, germa "ç" përcakton se Prokurori i Përgjithshëm "propozon dhe administron buxhetin e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm". Prokurori i Përgjithshëm në bashkëpunim dhe me prokuroritë e tjera të Juridiksionit të Përgjithshëm i ndihmuar nga strukturat administrative të Prokurorisë së Përgjithshme harton buxhetin e prokurorisë në përputhje me nevojat e prokurorive dhe bazuar në legjislacionin përkatës. Prokurori i Përgjithshëm ka për detyrë të mbrojë investimin e parave publike në Prokurori, të sigurojë që buxheti është planifikuar, ekzekutuar, monitoruar, dhe vlerësuar si duhet, dhe i kryen këto detyra në atë mënyrë që të sigurojë mirëfunksionimin e institucionit. Procedurat e duhura buxhetore dhe të prokurimit publik janë themelore për funksionimin e sistemit të prokurorisë. Prokurori i Përgjithshëm duhet të tregojë kujdesin maksimal në marrjen e vendimeve se si do të alokohen burimet financiare të vëna në dispozicion dhe të prioritzojë veprimtaritë në përputhje me kufizimet buxhetore në bashkëpunim me drejtuesit e prokurorive. Ai/ajo duhet të marrë hapa për të siguruar kontroll të administrimit të buxhetit në pajtim me legjislacionin në fuqi nga ana e sektorit të auditimit dhe bashkëpunim edhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit. Në të njëjtën mënyrë do të menaxhohen dhe burimet financiare të siguruara sipas ligjit nga donatorët vendas apo të huaj, ku nëpërmjet paraqitjes së projekteve të përcaktohen prioritetet financiare dhe fondet të menaxhohen me kujdes dhe efikasitet kundrejt transparencës dhe llogaridhënies.

c. *Përmirësim i kushteve të punës dhe krijim i një ambienti motivues.*

Përpjekjet për të përmirësuar funksionimin e sistemit të prokurorisë dhe rritjen e performancës duhet të fokusohen drejt përmirësimit të infrastrukturës fizike, dhe pajisjeve në dispozicion të prokurorëve dhe stafeve.

d. *Përmirësim i funksionimit të strukturave të teknologjisë së informacionit me qëllim;*

- Krijimin e një sistemi të konsoliduar të të dhënave, që informon qartë dhe saktë mbi numrin dhe llojin e çështjeve të regjistruara, të filluara, të përfunduara deri në dënime të përfundimtare dhe ekzekutimin e këtyre dënimeve, që gjenerohet nga sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve.



Mancoj

- Vënien në eficiency të plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve,
- Përmirësimin e programeve të përpunimit të të dhënave statistikore,
- Rritjen e sigurisë së rrjeteve dhe softveve kundrejt krimit kibernetik dhe hakërimit, duke bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtar dhe me Agjensinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Kjo do të realizohet nëpërmjet trajnimit të vazhdueshëm të stafit dhe blerjes së programeve të licensuara për rritjen e sigurisë së sistemeve.
- Në bashkëpunim me AKSHI, implementimin dhe përmirësimin e shërbimit "ONE DRIVE". Me OneDrive tashmë është e lehtë për të krijuar, modifikuar dhe ndarë dokumentet e punës mes kolegët.
- Marrjen e masave të nevojshme që të sigurojnë mbështetje të prokurorive të shkallës së parë dhe të apeleve me burimet e kërkuara njerëzore, financiare, teknike e logjistike, si dhe rritjen e ekspertizës zbuluese e hetimore, pajisjen me mjete teknike bashkëkohore etj.

e. *Sigurim i një sistemi të përshtatshëm sigurie për prokuroritë e të gjitha niveleve.*

IV. **Vizioni për të menaxhuar burimet njerëzore në sistemin e Prokurorisë**

Që sistemi i Prokurorisë të mund të përgjigjet në mënyrën e duhur, dhe në cilësinë e kërkuar në përmbushjen e detyrave kushtetuese dhe ligjore duhet të adaptohet një numër burimesh njerëzore dhe financiare të përshtatshme. Përcaktimi i numrit të prokurorëve dhe Propozimi në Kuvend për miratim i këtij numri bëhet sipas nenit 18 të ligjit nr.97/2016 nga Prokurori i Përgjithshëm duke patur parasysh disa indikatorë vlerësimi; a) raportin mbi ngarkesën e punës së prokurorëve, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e Këshillit të Ministrave për luftën e kriminalitetit gjatë tri viteve të fundit; b) garantimin e veprimtarisë së prokurorisë dhe njëkohësisht sigurimin e aksesit të shtetasve në shërbimin e prokurorisë, rritjen e cilësisë së këtyre shërbimeve, uljen e shpenzimeve dhe përdorimin e të ardhurave në mënyrë eficiente. Për vlerësimin e këtyre indikatorëve është e nevojshme që të bashkëpunohet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkollën e Magjistraturës dhe drejtuesit e prokurorive të të gjitha niveleve, në mënyrë që të përpilohen raporte të detajuara ku të analizohen nevojat për rritjen e numrit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, ose vijimin me të njejtin numër por rishpërndarjen e tyre, duke aplikuar mekanizmat e parashikuara nga ligji, sipas nevojave të çdo prokurorie pasi aktualisht për shkak të largimit të prokurorëve nga procesi i rivlerësimit, mbushjes së moshës për pension pleqërie apo dorëheqjet është ulur numri i prokurorëve, gjë që është bërë problem për funksionimin e duhur të prokurorive, sidomos atyre pranë gjykatave të apelit.

Për të menaxhuar në mënyrë të sukseshme përmbushjen e funksionit nga sistemi i Prokurorisë duhet të merren masa efektive për të garantuar që prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore dhe stafi administrativ të ushtrorë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre profesionale në kushte të përshtatshme ligjore dhe organizative. Prokuroritë e të gjitha niveleve duhet të jenë në dispozicion mjetet e nevojshme buxhetore. Vizioni është që të krijojmë një Prokurori të menaxhohet e drejtuar nga parimet e llogaridhënies dhe transparencës, të sigurojmë sistemi të jetë jo vetëm eficient, por të shmangë çdo mundësi të ndikimit të paligjshëm brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik ose privat në autonominë e prokurorëve në procesin e vendimarrjes.

1. Hapat që do të ndërmerren gjatë dy viteve të para në drejtim të menaxhimit të burimeve njerëzore;



Handwritten signature

-Së pari do të njihem me objektivat e institucionit në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore, qoftë për Prokurorinë e Përgjithshme, qoftë për prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithshëm të të dy niveleve. Do të vlerësoj përputhshmërinë ligjore të objektivave si dhe strategjinë e institucionit për realizimin e këtyre objektivave. Gjetjet e kësaj analize do të shërbejnë për hartimin e strategjisë së ardhshme për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe eliminimin e problematikave të konstatuara brenda sistemit.

- Do të vlerësoj gjëndjen e strukturave dhe organikave, përputhshmërinë e strukturave dhe organikave me rregulloret e brendshme të funksionimit duke diskutuar konkretisht si me drejtorët e drejtorive ashtu dhe me drejtuesit e prokurorive me qëllim që të përcaktohen qartë detyrat e strukturave si dhe veprimtaritë operationale të çdo punonjësi. Do punohet mbi përmirësimin dhe miratimin e strukturës së përgjithshme dhe rregullores standarte të organizimit dhe funksionimit të prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të Prokurorisë së Përgjithshme, sipas përcaktimeve të nenit 20 të ligjit nr.97/2016. Do kërkoj që në rregulloret e brendshme të çdo prokurorie jo vetëm të përcaktohen detyrat funksionale, por edhe përgjegjësite që ka çdo punonjës për realizimin e tyre

- Në fazën e përgatitjes së projekt – buxhetit të ardhshëm do tu kërkoj prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm që të argumentojnë kërkimet për një buxhet të mjaftueshëm për funksionimin e qartë dhe të pavarur të strukturës së tyre, të parashikojnë në mënyrë të argumentuar nevojat për burime njerëzore sidomos ato mbi limitin e fiksuar në strukturë. Të argumentojnë qartë volumin e punës për shtesat që kërkojnë në burimet njerëzore, nëse kërkojnë shtesa të tilla.

-Do të ndërtoj sisteme pune për të vlerësuar performancën e çdo punonjësi dhe nëse në të ardhmen do të ketë më shumë hapësira ligjore, vlerësimin do ta stimuloj midis të tjerave edhe me shpërblime financiare, sipas ligjit, si dhe motivim për ngritje në detyrë.

- Do bashkëpunoj me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës për përgatitjen e modaliteteve të kualifikimit të vijueshëm të punonjësve jo prokurorë të prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm.

- Ne kushtet kur Ligji nr.97/2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" nuk përcakton në mënyrë eksplicite si konfirmohet statusi i nëpunësve civil ekzistues do të bashkëpunoj me Drejtorinë e Departamentit të Administratës Publike për të përcaktuar procedurat administrative për të formalizuar statusin e punonjësve të administratës së Juridiksionit të Përgjithshëm. Do të nënshtrohen kontrollit dhe monitorimit, rekrutimi i stafit administrativ që është bërë nga të gjitha prokuroritë pas hyrjes në fuqi të ligjit, duke marrë masat e nevojshme për eliminimin e çdo paligjshmërie.

-Do të punohet për avancimin e teknologjisë së informacionit dhe infrastrukturës së nevojshme për të pasur një administratë funksionale dhe në shërbim të punës.

-Do t'i kushtohet vëmendje e veçantë specializimit dhe trajnimit të prokurorëve dhe stafit të prokurorive që kanë si detyrë bashkëpunimin me mediat.



Handwritten signature or mark in the bottom left corner.

-Do të percaktohen rregulla të qarta mbi procedurën e zgjedhjes së Zëvendësprokurorit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme dhe do të procedohet me emërimin e tij.

-Do të miratohen rregulla të detajuara për emërimin e zëvendësdrejtuesit të prokurorisë.

-Do të bashkëpunohet me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për përcaktimin e rregullave të detajuara lidhur me procesin e emërimit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe emërimin e tij si nëpunësi më i lartë civil i sistemit.

-Do të studiohen nevojat e prokurorive mbi ngritjen dhe fuqizimin e sektorëve të ekspertizës, që asistojnë prokurorët dhe vënien në dispozicion të mjeteve të posaçme teknike.

-Të monitorohet nëpërmjet kontrollit të brëndshëm nëse është bërë administrimi nga Sekretari i Përgjithshëm dhe kancelarët i çdo i dosjeje individuale për çdo nëpunës civil dhe punonjës të administratës së prokurorisë, sipas rregullave të përcaktuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Gjithashtu të monitorohet nëpërmjet Departamentit të Administratës Publike nëse janë hedhur në Regjistrin Qendror të Personelit, të krijuar dhe administruar nga Departamenti i Administratës Publike, sipas parashikimeve të ligjit "Për nëpunësin civil" dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij, të dhënat profesionale për çdo nëpunës civil të prokurorisë dhe punonjës të administratës, si dhe çdo të dhënë tjetër në lidhje me shërbimin civil ose marrëdhënien e punës, si dhe informacionin për strukturën dhe organikën e prokurorisë përkatëse.

-Të sigurohet bashkëpunimi me Departamentin e Administratës Publike, në cilësinë e administratorit të Regjistrin Qendror të Personelit, që t'u krijohet prokurorive akses të nevojshëm mbi të dhënat e prokurorive në këtë regjistër.

2. Hapat që do të ndërmerren gjatë dyvjeçarit të dytë;

Së pari do të analizohet performanca e vitit të kaluar; do të identifikohen arritjet dhe dështimet. Do të parashikohen masat që do të ndërmerren për realizimin e objektivave të parealizuara dhe çdo objektivi tjetër që do të shërbejë për përmirësimin e funksionimit të strukturës.

3. Hapat që do të ndërmerren deri në mbarimin e mandatit.

- Nëpërmjet ndërmarrjes të hapave të mësipërm deri në fund të mandatit do të përcaktohet për të krijuar një sistem prokurorie eficient, të pavarur, transparent, dhe llogaridhënës. Synimi më madhor do të jetë ai i ngritjes së një sistemi që do të përngjajë standardeve me të mira ndërkombëtare që duhet të ketë Prokuroria si organ i ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq në emër të shtetit. Një sistem që për nga profesionalizmi, kurajoja, paanshmëria dhe objektiviteti në përmbushjen e detyrës në interes të publikut do të sigurojë respektin dhe besimin se në Shqipëri funksionon shteti ligjor dhe se prokurorët kanë treguar vullnet për fuqizimin e tij. Një sistem që do të gezojë vlerësimin dhe do të nxisë dëshirën për bashkëpunim të institucioneve dhe organizmave ndërkombëtarë, që kanë për qëllim të përbashkët luftën kundër kriminalitetit dhe rikuperimin e dëmit që ai i sjell shoqërisë.



[Handwritten signature]

V. Përvoja praktike në sistemin e drejtësisë penale, duke përfshirë edhe çështjet thelbësore të të drejtave të njeriut

1. Përvoja e deritanishme,

Përvoja ime në sistemin e drejtësisë është e gjatë dhe jam munduar ta pasqyroj sa më hollësisht ne kerkesën time për kandidim dhe të dhënat personale bashkelidhur kërkesës.

Personalisht kam studiuar për shumë vite në fushën e të drejtave të njeriut dhe doktoratura që sapo kam mbaruar në Universitetin Middlesex të Londrës ka në fokus të saj analizën e respektimit të të drejtave të pronësisë në shoqërinë shqiptare në tranzicion përballë standarteve të vendosura nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Kam bërë përpjekjet maksimale, për aq kompetenca sa më ka dhënë ligji si prokuror që të respektoj të drejtat e të pandehurve në hetim dhe gjykim, duke treguar kujdes të veçantë për të pandehurit e mitur, por edhe të drejtat e viktimave.

Në çdo seminar ku kam kontribuar si ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, falë edhe arsimit tim, më është caktuar të referoj mbi nevojën e respektimit të standarteve të respektimit të të drejtave të njeriut në procesin penal të vendosura nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut në jurisprudencë e saj, veçanarisht në lidhje me përgjimet.

2. Hapat të cilët do të ndërmerren për të rritur nivelin e besueshmërisë së publikut në sistemin e prokurorisë.

Mundësia e prokurorisë që të përmbushë funksionet e saj bazohet thellësisht në besueshmërinë që ka publiku tek sistemi. Pushteti gjyqësor përgjithësisht e fiton këtë besim duke përmbushur funksionet e tij në respekt të ligjit, duke respektuar standartet etike, duke siguruar një llogaridhënie të paanshme dhe efektive të veprimtarisë së tij. Aktualisht një besim i tillë rezulton si shumë i cënuar bazuar në shumë faktor tashmë të mirë analizuar në studimet që paraprinë reformën në drejtësi, ku u parashikua së ndërhyrjet në legjislacion dhe reformat e tjera do të rrisnin nivelin e besueshmërisë të institucioneve nën reforme, një prej të cilave është edhe Prokuroria.

Zhvillimet teknologjike, mënyrat e reja të komunikimit me publikun luajnë rëndësi të madhe në mënyrën se si portretizohet gjyqësori/prokuroria dhe anëtarët e saj. Kjo do të zhvillime japin mundësi të reja komunikimi me publikun, por gjithmonë mbanë një komunikim që përballet me sfiden e kufizimeve që vijnë për shkak të sekreteve hetimore, të përfshirjes në hetime të të miturve.

Për të siguruar një rritje të besueshmërisë së publikut në sistemin prokurorial gjykoj se duhet të aplikohen disa strategji kryesore,

- a. Të sigurohet një standart i lartë profesional, duke rritur integritetin e prokurorëve, policisë gjyqësore dhe stafit në tërësi të prokurorisë brenda dhe jashtë institucionit. Kjo do të sigurohet nëpërmjet rritjes së nivelit të edukimit dhe trajnimit për prokurorët dhe punonjësit e tjerë të prokurorisë mbi sjelljen etike, integritetin dhe llogaridhënies për shkelje të etikës.



Handwritten signature

- b. Të realizohet në mënyrë periodike kontrollet e brendshme dhe respektohen programet e auditimit për mirëadministrimin e buxhetit dhe materialeve në përdorim nga ana e prokurorive të çdo niveli.
- c. Të respektohen me korrektësi dhe transparencë procedurat ligjore për emërimin dhe promovimin në detyrë të prokurorëve, policisë gjyqësore, dhe stafit të prokurorive të të gjitha niveleve, duke promovuar shanset e barabarta, transparencën, profesionalizmin dhe paanësinë politike.
- d. Të përmbushen me korrektësi përgjegjësitë për kontrollin dhe llogaridhënien sipas ligjit, të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore dhe gjithë stafit të prokurorisë.
- e. Të krijohen strukturat brenda Prokurorisë që merren me marrëdhëniet me publikun dhe median, struktura në të cilat duhet të punësohen individë të mirëtrajnuar për përmbushjen me korrektësi dhe profesionalizëm të detyrës.
- f. Në respekt të sekretit hetimor dhe mbarëvajtjes së hetimeve, por edhe të të drejtave të palëve në proces, të sigurohet nga prokurorët e specializuar për marrëdhëniet me mediat, dhënia e një informacioni korrekt për mediat dhe publikun. Për të realizuar këtë në çdo prokurori duhet të specializohen prokurorët për realizimin e kësaj detyre. Kjo arrihet duke zhvilluar sesione të veçanta trajnimi pranë Shkollës së Magjistraturës.
- g. Të trajtohen me seriozitet dhe korrektësi çdo kërkesë dhe ankesë e paraqitur nga publiku në çdo nivel të prokurorisë. Mbi trajtimin e kërkesave dhe ankesave do të përgatitet nga Prokuroria e Përgjithshme edhe një rregullore e posaçme mbi mënyrën e trajtimit të tyre. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Teknologjisë dhe Informacionit krijimin e një linku apo hapsire brenda faqes së internetit të institucionit ku qytetari apo publiku të ndjekë online trajtimin e kërkesës së tij.
- h. Përmirësimin në shpërndarjen e informacioneve rreth Prokurorisë, për të realizuar këtë duhet të zhvillohet një strategji komunikimi që ka parasysh zhvillimet në gazetari dhe komunikimin elektronik. Të sigurohet komunikim dhe bashkëpunim me institucione dhe organizma të ndryshme publike apo private për të përmirësuar të kuptuarit e rolit dhe funksioneve të prokurorisë.
- i. Të sigurohet mënyra e angazhimit të Prokurorëve në programet e edukimit të publikut për rolin e Prokurorisë si aktor i sistemit të drejtësisë dhe ndihmën që publiku duhet t'i ofrojë Prokurorisë në përmbushjen e detyrës së saj.

Realizimi i gjithë këtyre strategjive do të mund të bëhet vetëm me anë të bashkëpunimit gjithëpërfshirës me Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Shkollën e Magjistraturës, Departamentin e Administratës Publike, Ministrinë e Drejtësisë dhe Financave, drejtuesit e prokurorive të të gjitha niveleve, institucionet e tjera publike apo private apo organizmat ndërkombëtarë që merren me edukimin e publikut për sistemin e drejtësisë dhe partneret ndërkombëtare që kontribuojnë në rritjen e nivelit profesional dhe etik të prokurorëve.

3. Hapat dhe planifikimet që do të kryhen për të evidentuar nëse në sistemin e Prokurorisë respektohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në suport të idesë se mënyra më e mirë për një sistem prokurorie për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut është rritja e nivelit profesional³ gjykoj se në bashkëpunim

³ Thomas Hammarberg, 'The prosecutor: a pillar for democratic society' (Speech at the Conference of Prosecutors General of Europe, *The role of public prosecution in the protection of human rights and other interests outside the criminal law field*, organised by the Council of Europe and the Prosecutor General's Office



me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës duhet ti kushtohet rëndësi e veçantë rritjes së nivelit profesional të prokurorëve dhe trajnimit të tyre të vazhdueshëm duke u fokusuar tek të drejtat e të pandehurve në proces, të drejtat e viktimave, mbrojtja e dëshmitarëve dhe standartet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe jurisprudenca jonë kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Përgatitja e udhëzimeve që kanë për qëllim promovimin e drejtësisë dhe qëndrueshmërisë së qasjes gjatë kryerjes së hetimeve dhe në marrjen e vendimeve gjatë procesit të hetimit, por edhe gjatë gjykimit.

Synimi i këtyre udhëzimeve do të jetë që të orientojnë prokurorët që gjatë ushtrimit të detyrës ata,

- a. Duhet të përmbushin detyrimet e tyre në respekt të të drejtave kushtetuese të individëve, me paanësi duke evituar çdo lloj diskriminimi politik, social, fetar, racial, kulturor, seksual apo çdo formë tjetër diskriminimi.
- b. Të veprojnë në mbrojtje të interesit publik duke proceduar me objektivitet, duke respektuar pozicionin ligjor të të dyshuarit dhe viktimës, duke i kushtuar vëmendje çdo rrethane të dalë nga hetimi pavarësisht nëse është në avantazh apo disavantazh të të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale.
- c. Të ruajnë të dhënat personale të siguruara gjatë hetimit të çështjes për çdo individ të përfshirë në hetim.
- d. Të respektojnë të drejtat e njohura nga ligji procedural për viktimën, bashkëpunim me organizmat përkatës për asistencë ndaj tyre.
- e. Mospëtojnë të drejtat e individëve duke filluar çështje penale për të cilat sipas ligjit nuk mund të fillojë apo vijojë ndjekja penale.
- f. Prokurorët duhet ti kushtojnë vëmendje të madhe hetimit të krimeve të kryera nga nëpunësit shtetëror në detyrë, shpërdorimit të detyrës prej tyre, korrupsionit dhe pasojave që këto krime kanë shkaktuar tek shtetasit.
- g. Mospërdorim i provave të siguruara në kundërshtim me urdhërimet ligjore, të marra në dhunim të të drejtave të individit dhe vënje para përgjegjësisë deri edhe në penale e atyre që morën këto prova.
- h. Respektim i të drejtave të të miturve në proces nëpërmjet aplikimit të drejte të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit.

Monitorim i zbatimit të këtyre udhëzimeve edhe në kuadër të ankesave të qytetarëve në bashkëpunim edhe me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë.

Hartimi i një udhëzimi, në respekt të ligjit, për aplikim nga ana e prokurorëve të kërkimeve në gjykatë të shpërblimit të dëmit shkaktuar viktimave, nga ana e të pandehurve të deklaruar fajtor, si kusht për aplikimin e pezullimit të dënimeve penale. Të mbështesin kërkesat e bazuara në ligj për dëmshpërblim të personave që janë dëmtuar gjatë keqadministrimi i drejtësisë.

Emri Mbiemri Nënshkrimi

Data dhe vendi i nënshkrimit

Fatjona Dhanogj

06.04.2019 Tiranë



of the Russian Federation, Saint Petersburg, 1-3 July 2008) 2 < <https://rm.coe.int/16806d17af> > aksesuar 25 Prill 2019.